

Verzioni anglëzë me mbizotru
Енглеска верзија савладати
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Seanca nr.2002/20
Prishtinë, më 14 nëntor 2002, ora 10:15 minuta
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.
Kryesuesi konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë, gjithsej 84. Për këtë seancë ishte propzuar ky

REND I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesverbali nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i dytë i "P/ligjit për Tregti të Jashtme-2002/6";
4. Rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës për emrimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve;
5. Shqyrtimi i parë i "P/ligjit për Pyjet e Kosovës-2002/10"; dhe
6. Parashtrimi i pyetjeve.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryesusi i informoi deputetët e Kuvendit me shkresën që kishte arritur nga Qeveria e Kosovës, me të cilën kërkohet shtyrja e shqyrtimit të parë të "P/ligjit për Pyjet e Kosovës" me arsyetim se në këtë seancë nuk mund të marrë pjesë Ministri i bujqësisë dhe zhvillimit rural, i cili duhet ta arsyetonte P/ligjin dhe këte do ta bëjë në seancën e ardhshme plenare.

Haki Shatri, tha se "P/ligji për Tregti të Jashtme" asnjëherë nuk është shtyer për shkak të mos punës së Komisionit për buxhet. Komisioni nuk ka pasur mundësi t'i shqyrtojnë komentet e këshilltarit juridik të PSSP-së, për shkak se ato kanë ardhur me vonesë, është e pamundur që ato të

shqyrtohen gjatë pauzës eventuale të sotme, andaj ai propozoi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit të bëhet në seancën e ardhshme.

Bajrush Xhemajli, tha se Komisioni për Tregti dhe Industri me kohë e ka shqyrtuar “P/ligjin për Tregti të Jashtme”, por zhvaritja e punës dhe mos miratimi i këtij P/ligji është nga ana e UNMIK-ut, i cili i ka bërë komentet-vërejtjet në atë P/ligj dhe ato deri dje nuk kanë qenë të përkthyer dhe nuk kanë mundur t’i shqyrtojnë.

Sadudin Berisha, tha se Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve me kohë e ka shqyrtuar “P/ligji për Tregdi të Jashtme” dhe i ka paraqitur rekomandimet e veta lidhur me te. Ismajl Kurteshi, pyeti se ndërhyrja e UNMIK-ut në “P/ligjin e Tregtisë së Jashtme” mos është tejkalim i kompetencave të tij?

Kryesusi, tha se Sekretaria i ka sygjerruar që ta shtyjë shqyrtimin e dytë të “P/ligjit të Tregtisë së Jashtme” për seancën e ardhshme. Kryesusi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

2. Procesverbali nga seanca e kaluar.

Deputetët nuk patën vërejtje në procesverbalin e Seancës së kaluar, andaj ai u miratua.

3. Rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë për emrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kryesusi hapi debat lidhur me ato rekomandime.

Arsim Bajrami, tha se Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe kornizë kushtetues i ka shqyrtuar rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës, për secilin kandidat vec e vec. Dispozitat ligjore për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë parashohin dy kushte themelore: a) të kenë mbaruar studjimet në drejtësi dhe b) të kenë të dhënë provimin e judikaturës. Duke u nisur nga të dhënat që kemi pasur në disponim, tha z. Bajrami kemi bërë një propozim që ka tri rekomandime për Kuvendin e Kosovës: a) kandidatët që rekomandohen t’i propozohen PSSP-së për zgjedhje; b) kandidatët të cilët nuk propozohen për zgjedhje, për shkak se Komisioni ka gjetur të dhëna në karrierën e tyre profesionale pas viteve 90-ta ata kanë qenë të implikuar në sistemin e gjyqësisë, në kohën kur është rrënuar sistemi gjyqësor i Kosovës; dhe c) kandidatët për të cilët Komisioni rekomandon që të shtyhet zgjedhja e tyre, derisa nuk sigurohen të dhëna plotësuese për ta, të cilat janë relevante për punën e Komisionit.

Muhamed Kelmendi, tha se ka marrë pjesë në punën e Komisionit i cili i ka shqyrtuar rekomandimet e Këshillit dhe ka shprehur qëndrimet e tija në dy çështje të rëndësishme. 1) shumica nga të rekomanduarit nuk e kanë të dhënë provimin e jurisprondencës dhe 2) ku kanë shërbyer të rekomanduarit pas vitit 89, kur është rrënuar sistemi gjyqësor i Kosovës? Kam të dhëna, tha z. Kelmendi se shumica e të rekomanduarëve kanë vazhduar të